

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7846  
E enjte, 27 korrik 2024  
Çmimi 0.50

## Aivo Orav emërohet ambasador i ri i BE-së në Kosovë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## SA PUNOHET PËR RIINTEGRIMIN E TË BURGOSURVE NË SHOQËRINË E KOSOVËS?

FAQE 4



Pas arratisjes së Faton Hajrizit, i cili u vra nga autoritetet në Serbi, i dyshuar për vrasjen e një oficeri policor serb, në Kosovë u ngrit çështja nëse

institucionet po bëjnë mjaftueshëm për rehabilitimin e të burgosurve. Shërbimi Korrektues i Kosovës ofron disa programe të cilat synojnë t'i

risocializojnë dhe t'i riintegrojnë të burgosurit në shoqëri. Por, organizatat që monitorojnë burgjet i vlerësojnë ato të mangëta

## GJASHTË VJET PA ADEM DEMAÇIN, SIMBOLIN E SAKRIFICËS E TË RESISTENCËS

F. 6



## NDEROHEN POLICËT E RËNË NË KRYE TË DETYRËS: ME POLICË TRIMA KOSOVA DO T'I DALË ZOT GJITHË TERRITORIT

F. 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mok: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## AKTUALE



## BARACK DHE MICHELLE OBAMA MBËSHTESIN KAMALA HARRISIN PËR GARËN PRESIDENCIALE

F. 2


## A MUND TË HAPET URA NË MITROVICË PA PAJTIMIN E KFOR-IT?

F. 5

## NIS FESTIVALI I MUZIKËS 'SUNNY HILL'

F. 6

## EKONOMI



## ULJE E PERCEPTIMIT PUBLIK PËR KORRUPSION NË ATK

F. 8

## FMN-ja KONFIRMON MBËSHTETJEN NDAJ BQK-së

F. 8

## SPORT



## KURTI MORI PJESË NË DARKËN E SHTRUAR NGA PRESIDENTI I KOMITETIT NDËRKOMBËTAR OLIMPIK

F. 10



## Barack dhe Michelle Obama mbështesin Kamala Harrisin për garën presidenciale

WASHINGTON, 26 KORRIK - Ish-presidenti amerikan Barack Obama dhe ish-Zonja e Parë, Michelle Obama, kanë mbështetur Kamala Harrisin për garën e saj për Shtëpinë e Bardhë. Nënpresidentja amerikane tani ka marrë një mbështetje të rëndësishme nga dy nga demokratët më popullorë në Shtetet e Bashkuara. Mbështetja, që u bë publike më 26 korrik përmes një videoje ku shfaqet Harris duke biseduar në telefon nga çifti Obama, vjen në kohën kur Harris po vazhdon të ndërtojë momentum, teksa me gjasë ajo do ta fitojë nominimin partiak për presidente. Synimi i Harrisit për të garuar për presidente vjen pasi presidenti amerikan Joe Biden u tërhoq nga gara dhe ofroi mbështetje për zëvendësen e tij për të garuar kundër kandidatit republikan, ish-presidentit Donald Trump. "Të telefonuam për të thënë se Michelle dhe unë jemi shumë krenarë që të mbështesim dhe do të bëjmë gjithçka që mundemi që të shkoni në Zyrën Ovale", i tha ish-presidenti

Harrisit. Ndërkaq Michelle Obama tha se "Kamala, jam shumë krenare me ty". "Kjo do të jetë historike", shtoi ajo. Harris, e cila e njehtin çiftin Obama që para se Barack Obama t'i fitonte zgjedhjet e 2008-s, i falënderoi për miqësinë e tyre dhe tha se mezi pret që të jenë bashkë në fushatën për zgjedhjet presidenciale të 5 nëntorit. Barack dhe Michelle Obama ndoshta janë figurat e fundit të larta të partisë që mbështesin Harrisin zyrtarisht. Sipas një hulumtimi të Associated Press, Harris veçse ka siguruar mbështetjen publike të shumicës së delegatëve në Kuvendin Kombëtar të Partisë Demokratike, i cili do të mbahet nga 19 gushti deri më 22 gusht në Çikago. Biden e kishte mbështetur menjëherë Harrisin pasi njoftoi për tërheqjen nga gara, mes shqetësimeve se presidenti 81-vjeçar nuk mund ta mposhtë Trumpin. Ish-kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi,



lideri i shumicës në Senat, Chuck Schumer, lideri i demokratëve në Dhomë, Hakeem Jeffries, ish-presidenti Bill Clinton, ish-sekretarja e Shtetit, Hillary Clinton, janë disa nga figurat që

kanë mbështetur Harrisin. Çifti Obama, megjithatë, pas tërheqjes së Bidenit nuk e mbështetën menjëherë Kamala Harrisin. Në deklaratën fillestare pas tërheqjes së Bidenit, Barack

Obama nuk e përmendi Harrisin, por lavdëroi Bidenin për punën e bërë. Çifti Obama kishin marrë pjesë në fushatën e Hillary Clintonit më 2016 dhe më 2020 të Bidenit.

## Guterres: Njerëzimi po vuan prej 'epidemisë së nxehtësisë ekstreme'



NJU-JORK, 26 KORRIK - Njerëzimi është duke vuajtur prej "epidemisë së nxehtësisë ekstreme", ka thënë shefi i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, i cili ka bërë thirrje për të vepruar, në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi i valëve të të nxehtë, të cilat janë rezultat i ndryshimeve klimatike. "Miliarda njerëz janë duke u përballur me epidemi të nxehtësisë ekstreme - duke përfshirë valë të të nxehtë, temperatura gati 50 gradë celsius", ka thënë ai. Sipas agjencisë evropiane, Copernicus, 21, 22 dhe 23 korriku kanë qenë tri ditët më të nxehta ndonjëherë në histori, ndërsa 22 korriku ka shënuar rekordin e të gjitha kohëve, me 17.16 të

temperaturës mesatare të ajrit. Guterres e ka përsëritur thirrjen e tij që njerëzimi ta luftojë "varësinë" ndaj lëndëve djegëse të papërpunuara. "Sot fokusi ynë është në ndikimin e nxehtësisë ekstreme. Mirëpo, le të mos harrojmë se kemi edhe simptoma të tjera shkatërruese prej krizës klimatike: uragane të ashpra, vërshime, thatësi, zjarre pyjore, rritje të nivelit të ujërave. Dhe lista vazhdon", ka thënë ai. "Për t'i mposhtur të gjitha këto simptoma, ne duhet ta luftojmë sëmundjen. Dhe sëmundja është djegja e shtëpisë sonë të vetme. Sëmundja është varësia ndaj lëndëve djegëse të papërpunuara. Sëmundja është mosveprimi

klimatik", ka thënë ai, duke kërkuar sidomos veprim të 20 vendeve më të industrializuara në botë (G20). Ndonëse viti 2023 është konsideruar më i nxehti ndonjëherë, viti 2024 mund të thyjë rekord të ri, pasi temperaturat mbi 40 gradë po bëhen të zakonshme. Brenda një viti temperatura 50 gradë celsius është regjistruar në të paktën 10 vende, në Luginën e Vdekjes në Shtetet e Bashkuara, në Agadir të Marokos dhe në disa vende në Indi dhe Kinë. Nxehtësia ekstreme, e quajtur edhe si "vrasësja e heshtur", besohet se ka shkakuar vdekjen e 489 000 personave brenda vitit në periudhën 2000-2019.

## Ukraina thotë se ka zbrapsur sulme ruse në katër rajone

KIEV, 26 KORRIK - Mbrojtja ajrore ukrainase ka rrëzuar 20 nga 22 dronët e lëshuar nga Rusia ndaj caqeve në katër rajone të Ukrainës në orët e para të 26 korrikut. Kështu njoftoi forca ajrore ukrainase e cila tha se sulmet u kryen në rajonet e Hersonit, Sumit, Zhitomir dhe Çernihiv. Sulmet e reja ruse ndodhën një ditë pasi Moskë sulmoi instalacione në portin

ukrainas të Izmajilit në lumin Danub, afër kufirit të shtetit anëtar të NATO-s, Rumanisë. Kjo e nxitë NATO-n që t'i aktivizonte avionët luftarakë F-18 për ta monitoruar situatën. Ministria ruse e Mbrojtjes, ndërkaq, tha se mbrojtja e saj ajrore ka rrëzuar gjashtë dronë ukrainas, katër mbi rajonin e Rostovit dhe dy mbi atë të Kurskut. Rusia, që ka nisur pushtimin

në shkallë të plotë të Ukrainës shkurtin e vitit 2022, e sulmon shtetin fqinj me armë të llojeve të ndryshme, përfshirë dronë, raketa dhe armë kundërajrore. Pavarësisht prej dëshmime të shumta, udhëheqja ruse mohon se ushtria e saj sulmon caqet civile në qytetet dhe fshatrat ukrainase, duke shkakuar viktima në mesin e civilëve.





# Nderohen policët e rënë në krye të detyrës: Me policë trima Kosova do t'i dalë zot gjithë territorit

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 26 KORRIK** - Zëvendëskryeministri i Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, së bashku me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca, zëvendëskryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla dhe drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, Gazmend Hoxha, kanë bërë homazhe në Ditën Memoriale të Policëve të Rënë në kryerje të detyrës dhe 13-vjetorit të rënies së heroit Enver Zymeri, pranë lapidarit të policëve të rënë në kryerje të detyrës.

Në këtë ceremoni u përkujtua dhe nderua vepra e heroit Enver Zymeri, po ashtu edhe e të gjithë policëve të rënë në krye të detyrës. Në shënim të kësaj dite u përkujtua edhe vepra dhe rënia e heroit të Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili ra në mbrojtje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendit.

Në këtë ngjarje u tha se heronjtë tanë dhanë jetën e tyre në shërbim të vendit duke përmbushur detyrën e lartë shtetërore në kërkim të mbrojtjes së rendit, zbatueshmërisë së ligjit dhe integritetit dhe sovranitetit territorial.

Kryeministri Albin Kurti në "Facebook" ka theksuar se Enver

Zymeri është hero i ligjshmërisë demokratike dhe i sovranitetit republikan të Kosovës. "Kjo sa vjen e bëhet më e qartë në çdo përvjetor të rënies së tij, teksa gjendja në terren në pjesën veriore të Kosovës ka ndryshuar rrënjësisht që nga koha kur Enveri u vra, 13 vjet më parë", ka thënë Kurti, duke shtuar se operacioni i Policisë së Kosovës në Banjskë më 24 shtator 2023, gjatë sulmit terrorist të një grupi paramilitar të mbështetur nga autoritetet shtetërore të Serbisë, me qëllim destabilizimin dhe shpërndarjen e një pjese të territorit të Kosovës, është dëshmia më e mirë e nivelit të policëve të Kosovës dhe e faktit që angazhimi dhe rënia e Enver Zymerit nuk kanë shkuar kot. "Me policë trima si Enveri dhe si shokët e kolegët e tij, Kosova do t'i dalë zot gjithë territorit dhe qytetarëve të saj, duke e mbrojtur demokracinë dhe tërësinë e saj", ka thënë Kurti.

Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka theksuar se me konsideratën më të lartë e respekt të thellë i përkujtojmë sot me nderime të gjithë policët tanë të rënë në detyrë. "Duke bërë homazhe pranë pllakës përkujtimore kushtuar zyrtarëve të rënë policorë, shpreha vlerësimin e lartë ndaj aktit heroik të policëve tanë që dhanë jetën duke i shërbyer në mënyrë të pashoqe shtetit dhe qytetarëve tanë, me përpjekjen e tyre sublime për ta mbrojtur rendin ligjor e




kushtetues, në luftën kundër cenimit të integritetit territorial dhe sovranitetit të vendit tonë, si dhe kundër krimit të organizuar", ka deklaruar Konjufca.

Ai ka bërë vizitë në familjet e dy heronjve tanë, të Enver Zymerit dhe Afrim Bunjakut, të cilët me guxim dhe vendosmërinë e tyre, me dashurinë ndaj atdheut dhe përgjegjësinë e lartë ndaj detyrës, sakrifkuan jetën e tyre duke mbrojtur sovranitetin dhe ligjshmërinë e Republikës së Kosovës, që u kërcënuan nga strukturat kriminale dhe forcat paramilitare të dirigjuara prej Serbisë. "Kjo ditë e përkujtitit të

heronjve tanë policorë shënohet në datën e rënies së Enver Zymerit, i cili vdiq më 26 korrik të vitit 2011 pasi ishte qëlluar me armë nga strukturat kriminale të Serbisë, në operacionin për ta shtrirë kontrollin shtetëror në pikat kufitare. Homazhet i vijua pikërisht aty ku gjendet pllaka përkujtimore për nder të tij, në vendin ku ai ra heroikisht", është shprehur Konjufca, duke theksuar se sakrifica sublime e të gjithë zyrtarëve tanë policorë të rënë në detyrë i bënë ata heronj të shtetit tonë ndërsa, sipas tij, neve na bënë të përkulemi përballë këtij shembulli të dinjitetit dhe

përkushtimit, që do të na frymëzojë të gjithëve ne dhe brezat që do të vijnë, për të na kujtuar se jeta jonë bëhet gjithnjë e më e plotë kur ajo është në shërbim të forcimit të atdheut, e jetët e dhëna për të janë jetët të përjetshme, siç është atdheu ynë.

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka theksuar se sot dhe çdo ditë u janë mirënjohës djemve e vajzave tona që bartin nder e krenari uniformën e Policisë së Kosovës dhe shërbejnë e mbrojnë Republikën tonë, duke realizuar kështu aspiratat e 23 pjesëtarëve të Policisë së Kosovës të rënë në kryerje të detyrës.



## Aivo Orav emërohet ambasador i ri i BE-së në Kosovë

**PRISHTINË, 26 KORRIK** - Këshilli i Bashkimit Evropian ka emëruar diplomatit estonez Aivo Orav në pozitën e përfaqësuesit të posaçëm të BE-së në Kosovë. Sipas BE-së, ai do ta marrë detyrën më 1 shtator 2024 dhe do të ketë një mandat fillestar prej dy vjetësh, duke pasuar Tomas Szunyog, që ka qenë në këtë pozitë që nga viti 2020. "Orav

do të ketë rol udhëheqës në promovimin e një Kosove të qëndrueshme, paqësore, demokratike dhe multietnike, e cila bashkëpunon me rajonin. Ai mbështet perspektivën evropiane të Kosovës dhe afrimin me BE-në. Ai do të monitorojë, ndihmojë dhe lehtësojë përparimin në fushën politike, ekonomike dhe prioritetet

evropiane", tha BE-ja, raporton REL.

Shefi i ardhshëm i Zyrës së BE-së në Kosovë ka përvojë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, pasi më herët ka shërbyer shefi i delegacionit të bllokut evropian në Maqedoninë e Veriut dhe në Mal të Zi.

Orav aktualisht është përfaqësues i përhershëm i Estonisë në BE.







# A mund të hapet ura në Mitrovicë pa pajtimin e KFOR-it?

**PRISHTINË, 26 KORRIK** - Edhe pse kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, njoftoi në mes të korrikut se qeveria e tij synon ta hapë urën kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë, misioni ushtarak i NATO-s në Kosovë, KFOR, thotë se çdo vendim për hapjen e saj duhet të merret në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë i cili ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Në deklaratën dhënë "Radios Evropa e Lirë", KFOR-i tha se NATO-ja e mbështet këtë dialog dhe se ai është aty për të kontribuar në një mjedis të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës - në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme. "Kjo përfshin praninë e vazhdueshme në urën në Mitrovicë dhe patrullime të rregullta në zonën përreth", tha KFOR-i.

Ai nuk iu përgjigj pyetjes nëse dikush nga Qeveria e Kosovës e ka kontaktuar në lidhje me këtë çështje.

Në urën mbi Ibër patrullojnë ushtarët italianë të KFOR-it, ndërsa afër janë edhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Prandaj, nga sektori civil në Kosovë thonë se faktor kyç për hapjen e urës është, në fakt, KFOR-i, sepse ai duhet t'i lëvizë ushtarët e tij, gjegjësisht ta japë pëlqimin.

Kjo urë e ndan Mitrovicën në pjesën jugore të banuar me shumicë shqiptare dhe në pjesën veriore, ku komunitet shumicë

janë serbët.

Ura kryesore mbi lumin Ibër që nga viti 1999 e ndan Mitrovicën në pjesën jugore, të banuar me shumicë shqiptare, dhe në pjesën veriore, të banuar me shumicë serbe. Vendimi për hapjen e urës është marrë në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Veriut në prill të vitit 2023, por nuk është zbatuar ende.

Ura, aktualisht, është e hapur vetëm për këmbësorë, ndonëse, në kuadër të dialogut, është rënë dakord që të hapet edhe për trafik.

Derisa Qeveria e Kosovës beson se hapja e urës do të siguronte liri të lëvizjes për të gjithë, Serbia e sheh këtë çështje si "provokim". Më 17 korrik kryeministri i Kosovës e ngriti çështjen e hapjes së saj në një takim me ambasadorët e vendeve të QUINT-it dhe me shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, pas të cilit tha se "askush nuk mund të thotë se kjo nuk është një gjë e mirë dhe korrekte".

Vendet e QUINT-it përfshijnë: Shtetet e Bashkuara, Francën, Gjermaninë, Italinë dhe Britaninë e Madhe. "Duam që ligji të zbatohet, të respektohet liria e lëvizjes, por edhe të ketë paqe dhe siguri për të gjithë", u tha Kurti gazetarëve më 18 korrik, duke folur për hapjen e urës në Mitrovicë.

## Çfarë thotë QUINT-i?

Ambasada britanike në Kosovë i tha "Radios Evropa e Lirë" se

qëndrim i vendit të saj është që ura në Mitrovicë të hapet në përputhje me marrëveshjet përkatëse, të arritura në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Ne jemi të hapur për diskutime me Qeverinë e Kosovës se si mund të arrihet kjo", thuhet në përgjigje.

"REL"-i iu drejtua edhe ambasadave të tjera të shteteve të QUINT-it për t'i pyetur se cili është qëndrimi i tyre për hapjen e urës në Mitrovicë dhe nëse e përkrahin synimin e Qeverisë së Kosovës për ta hapur atë për qarkullim, por nuk mori përgjigje. Ngjashëm nuk u përgjigj as Bashkimi Evropian, por më herët ai rikujtoi se kjo çështje ka qenë temë e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve dhe se, për këtë arsye, të gjitha vendimet duhet të merren në kuadër të dialogut, me pjesëmarrjen e delegacioneve zyrtare të Prishtinës dhe Beogradit.

BE-ja, po ashtu, u bëri thirrje palëve t'i zbatojnë pa vonësë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog, përfshirë Marrëveshjen për urën, por të mos e rrezikojnë stabilitetin në terren.

## Çfarë parashikon Marrëveshja për urën?

Kosova dhe Serbia ranë dakord për hapjen e urës kryesore mbi Ibër për qarkullim në kuadër të

dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në vitin 2014.

Me të u parapa i ashtuquajti "rivitalizim i urës", me qëllim heqjen e të gjitha barrikadave dhe funksionalizimin e urës.

Barrikatadat e para në këtë urë u ngritën në vitin 2011 nga serbët vendas, në shenjë kundërshtimi ndaj shtrirjes së autoritetit të Prishtinës në veri.

Në vitin 2014 ato barrikada u zëvendësuan me gardhe prej betoni, të cilat autoritetet lokale në Mitrovicën e Veriut - të udhëhequra nga Lista Serbe - i quajtën "Parku i Paqes". Ky "park" u hoq në vitin 2016 - kohë kur ura mendohej të hapej për qarkullim. Në të njëjtin vit, Kosova dhe Serbia ranë dakord për një plan të ri zbatimi, qëllimi i të cilit ishte tejkalimi i mosmarrëveshjeve rreth interpretimeve të ndryshme që u bëheshin konkluzioneve të mëparshme.

Sipas planit të ri të zbatimit, hapja e plotë e urës ishte menduar të bëhej në janar të vitit 2017. Megjithatë, punimet për rivitalizimin e urës përfunduan në qershor të vitit 2018. Në atë projekt u investuan 1.5 milion euro. Në fund, ura nuk u hap për mjete motorike, por vetëm për këmbësorë.

## Si të hapet ura pa rrezikuar stabilitetin në terren?

Qeveria e Kosovës nuk iu përgjigj pyetjes së "REL"-it se si mund të

hapet ura mbi Ibër pa e rrezikuar stabilitetin në terren - ashtu siç kërkon bashkësia ndërkombëtare.

Arton Demhasaj nga organizata joqeveritare "Çohu" beson se ura kryesore në Mitrovicë duhet të hapet për lëvizje më të lehtë të të gjithë qytetarëve, por thekson se kjo duhet të bëhet në koordinim të plotë me KFOR-in dhe me vendet e QUINT-it. "Çdo veprim i njëanshëm dhe i pakoordinuar, i cili mund të shoqërohet me përshkallëzim ndëretnik të situatës, mund të ketë efekt të kundërt", thotë Demhasaj për "Radion Evropa e Lirë".

Ai shton se Qeveria e Kosovës, bashkë me KFOR-in dhe QUINT-in, duhet të bisedojnë me qytetarët e Mitrovicës së Jugut dhe të Veriut për rëndësinë e hapjes së urës. "Ura duhet të hapet [për trafik] kur të arrihet një marrëveshje", thotë Demhasaj. Qytetarët në jug dhe në veri të urës e shohin ndryshe-ndryshe hapjen e saj.

Nga radhët e komunitetit shqiptar i thanë më herët "REL"-it se ura duhet të hapet, sepse do të kontribuonte në bashkëpunim dhe liri të lëvizjes, ndërsa në mesin e serbëve besojnë se kjo çështje mund t'i ngrejë tensionet etnike.

Miodrag Marinković nga Qendra joqeveritare për Veprime Afirmative Sociale thotë se mandat i KFOR-it është sigurimi i paqes dhe stabilitetit në tërë territorin e Kosovës dhe se prania e tij në urë në vitet e fundit ishte



# Sa punohet për riintegrimin e të burgosurve në shoqërinë e Kosovës?

Pas arratisjes së Faton Hajrizit, i cili u vra nga autoritetet në Serbi, i dyshuar për vrasjen e një oficeri policor serb, në Kosovë u ngrit çështja nëse institucionet po bëjnë mjaftueshëm për rehabilitimin e të burgosurve. Shërbimi Korrektues i Kosovës ofron disa programe të cilat synojnë t'i risocializojnë dhe t'i riintegrojnë të burgosurit në shoqëri. Por, organizatat që monitorojnë burgjet i vlerësojnë ato të mangëta

**PRISHTINË, 26 KORRIK** - Qëllimi i një dënimi me burgim konsiderohet risocializimi dhe riintegrimi i një personi të burgosur në shoqëri. Por, nga organizatat joqeveritare thonë për Radion Evropa e Lirë se në institucionet korrektuese në Kosovë ka mungesë të programeve adekuata për ta arritur këtë qëllim. Sipas tyre, programet zakonisht janë grupore dhe të njëjta për të gjitha institucionet.

Që programet rehabilituese të jenë të suksesshme "duhet të vlerësohen nevojat individuale të secilit të burgosur, sepse secili ka karakteristika të veçanta dhe nevoja të veçanta për t'u rehabilituar dhe për t'u risocializuar", vlerëson Fatmire Haliti nga Qendra Kosovare për

Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), e cila monitoron punën e Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK).

Një tjetër sfidë, sipas Halitit, por edhe sipas ish-drejtorit të ShKK-së, Sokol Zogaj, është buxheti. Raporti vjetor për 2023-n i ShKK-së tregon se ai kishte një buxhet prej 20.7 milionë eurosh. Këtë vit ShKK-ja parashihet të ketë 8 milionë euro më shumë, kryesisht për investime kapitale. "Që të burgosurit të përmirësohen dhe të riintegrohen, duhet që shteti të paguajë, të ketë buxhet të madh, në mënyrë që t'ua sigurojë kushtet", thotë Zogaj për Radion Evropa e Lirë.

Ndërkaq Haliti thotë se, përveç mungesës së buxhetit, ka edhe

mungesë të kuadrove të specializuara për programet individuale për risocializim dhe riintegrim.

## Sfida e kategorizimit të të burgosurve

Shqetësues, po ashtu, vlerësohet kategorizimi i të burgosurve, por Zogaj thotë se për të vendosin gjykatat. Avokati i Popullit ka thënë se sa i përket kategorizimit, ka pasur përparim në institucionet e reja, por kjo sfidë mbetet në institucionet që janë në objekte të vjetra dhe nuk kanë hapësirë të mjaftueshme.

Edhe QKRMT-ja ka adresuar çështjen e kategorizimit, duke marrë shembull personat me çrregullime mendore, të cilët ka thënë se janë të shpërndarë në të gjitha institucionet, njësoj sikurse përdoruesit e substancave narkotike. "Në mungesë të kategorizimit, apo ndarjes së mirëfilltë të tyre, mungon edhe risocializimi apo rehabilitimi i tyre", thotë Haliti. Ajo shton se, për dallim nga e kaluara, tani ka më pak raste kur në një qeli vendosen persona që kanë dënime më të gjata me ata me dënime më të shkurtra.

## Kompensimi "dekurajues" për punë

Kosova ka disa qendra korrektuese dhe edukuese, si Qendrën Edukuese Korrektuese në Lipjan, Burgun e Sigurisë së Lartë, Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan, Qendrën Korrektuese në Dubravë, Qendrën Korrektuese në Smrekonicë dhe qendrat e paraburgimit në Gjilan, Mitrovicë, Lipjan, Prizren dhe Pejë. Në burgje - që janë të llojeve të ndryshme, sikurse të tipit të hapur, gjysmë të hapur dhe të mbyllur - ka edhe punishte, ku të burgosurit me sjellje të mirë lejohen të punojnë.

Në raportin e tij vjetor për 2023-n, Avokati i Popullit ka kërkuar përmirësim të kushteve të punës për të burgosurit dhe rritje të pagesës për ta. Aktualisht çdo i burgosur që punon paguhet 1 euro në ditë. Këtë kompensim Haliti e konsideron "dekurajues" për punën e të burgosurve brenda burgjeve. Megjithatë, ajo thotë se ka interesim mes tyre për të punuar.

Vitin e kaluar, histori suksesi, sipas QKRMT-së, u konsiderua Smrekonica, ku të burgosurve që

patën sjellje të mirë dhe nuk patën ndonjë incident iu mundësua puna jashtë burgut. Të burgosurit angazhohen në fusha të ndryshme, sikurse në bujqësi e blegtori, në prodhimin e letrave të tualetit e të qeseve plastike, por trajnohen edhe në floktari dhe roboaqepësi.

## Cilësia e shkollimit

Me qëllim të integritimit më të mirë në shoqëri, institucionet korrektuese në Kosovë ofrojnë edhe shkollim. Ndonëse të burgosurit në moshë madhore duhet të plotësojnë disa kriterë për t'iu mundësuar shkollimi, të miturve u sigurohet shkollim i vazhdueshëm.

Ndonëse QKRMT-ja vë në pah se cilësia në shkollimin e të miturve nuk është ashtu siç do të duhej të ishte, për shkak të mungesës së mësimit dhe për shkak të klasave të kombinuara, Zogaj, megjithatë, thotë se qendra për të mitur në Lipjan është më e mirë se ato në Ballkan.

Pavarësisht se institucionet korrektuese ofrojnë trajnime dhe punë për të burgosurit, kur ata dalin nga burgu nuk kanë një vend pune, por as nuk monitorohen - përveç atyre që lirohen me kusht.

## Përcjellja e përparimit

QKRMT-ja ka kërkuar që institucionet të hartojnë një strategji, e cila, përveç shërbimit korrektues, do ta përfshinte edhe përcjelljen e përparimit të risocializimit dhe të riintegritimit të tyre në shoqëri. Sipas Halitit, "ata, nëse lirohen nga burgu dhe nuk gjejnë një vend pune, një trajnim apo diçka tjetër, mund t'i përsërisin veprat penale". Gjendja e burgjeve në Kosovë është përmendur edhe në raportin e fundit për të drejtat e njeriut të Departamentit Amerikan të Shtetit, ku thuhet se burgjet dhe qendrat e ndalimit në Kosovë plotësojnë "disa standarde ndërkombe".

Megjithatë, sipas DASH-it, qendra e paraburgimit "vazhdojnë të kenë probleme, përfshirë raportimet për dhunë mes të burgosurve, ekspozim ndaj radikalizmit fetar dhe qëndrimeve politike dhe trajtimit jo të duhur të të burgosurve me probleme mendore".



garanci për këtë.

Ai thotë se "rezervimi" i KFOR-it, kur bëhet fjalë për hapjen e urës, mund të bëjë që autoritetet e Kosovës sërish të mos konsultohen me komunitetin që e prek vendimi i tyre. "E vetmja mënyrë për ta hapur urën pa shkaktuar tensione është që kjo të bëhet në një hapësirë simbolike, ku do të merrnin pjesë përfaqësuesit legjitimë të të dyja komuniteteve dhe ku do të arrihej një marrëveshje se si do të dukej gjithçka", thotë Marinković për Radion Evropa e Lirë.

Lista Serbe - partia kryesore e serbëve në Kosovë, e cila gëzon

mbështetjen e Beogradit - u shpreh më herët kundër hapjes së urës mbi Ibër. Sipas saj, një veprim i tillë synon "destabilizimin e mëtejshëm të situatës në terren".

Lista Serbe, po ashtu, kërkoi nga bashkësia ndërkombëtare që "t'i thotë Kurtit se hapja e urës nuk mund të bëhet pa pëlqimin e serbëve që jetojnë në veri të Kosovës".

Marinković beson, gjithashtu, se hapja e urës mbi Ibër është një "akt simbolik i autoriteteve të Kosovës, për të treguar se kanë marrë kontrollin e veriut".

Në katër komunat në veri të

Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq - popullata shumicë është serbe dhe ajo, prej vitesh, refuzon të integrohet në sistemin e Kosovës. "Janë tri-katër ura që njerëzit i shfrytëzojnë për të lëvizur nga jugu në veri. Ka rrugë, njerëzit lëvizin. Ura kryesore ka më shumë vlerë simbolike, sepse ka qenë pikë qendrore e konfliktit mes serbëve dhe shqiptarëve. Prandaj, është mbyllur. Për të arritur stabilitet. Nëse në hapjen e saj tani nuk përfshihen të dyja palët, ekziston mundësia që ky stabilitet të dëmtohet", thotë Marinković.

## Kush është përgjegjës për hapjen e urës?

Në prill të vitit të kaluar deputetët e Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut miratuan një vendim për hapjen e urës mbi Ibër, i cili më pas iu përcoll Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. "REL"-i i pyeti të dyja këto ministri nëse dhe në çfarë mënyre po shqyrtohet hapja e urës mbi Ibër, por nuk

mori përgjigje.

Nënkryetari i Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut, Skënder Sadiku, tha në fund të majit se përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi janë tani institucionet qendrore, KFOR-i dhe Bashkimi Evropian. Ai tha se me këtë vendim duhet të pajtohen edhe autoritetet lokale në Mitrovicën e Jugut.




## Nis Festivali i Muzikës "Sunny Hill"

Prishtinë, 26 korrik - Në Prishtinë nisi më 25 korrik Festivali i Muzikës "Sunny Hill", që organizohet nga fondacioni me të njëjtin emër i këngëtares shqiptare me famë ndërkombëtare, Dua Lipa. Në natën e parë të festivalit, i

cili do të zhvillohet deri më 28 korrik, admiruesit e muzikës i argëtoi një këngëtare tjetër e njohur me prejardhje shqiptare, Bebe Rexha. "Në lokacionin e ri, Festivali Sunny Hill, dhe mijëra të reja e të rinj, i dhanë Kosovës dhe botës një

ndër mbrëmjet më ikonike tonat. Kosova është plot rini e plot jetë. Kështu duhet të jetë. Kështu duhet të shpërfaqet jashtë gjithëherë!", ka vlerësuar lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, i cili ishte pjesë e hapjes së këtij festivali.



## Sërish dështon mbledhja e Kuvendit Komunal të Gjilanit, opozita nuk heq dorë nga kërkesa për transmetim medial

**GJILAN, 26 KORRIK** - Në mungesë kuorumi, për të katërtën herë radhazi ka dështuar të mbahet seanca e Kuvendit Komunal të Gjilanit, pasi opozita (LDK) e ka lëshuar sallën, me arsyetimin se komuna e Gjilanit nuk ka siguruar transmetim medial si në të kaluarën.

Opozitës (LDK-së) nuk i ka mjaftuar transmetimi në kanalën zyrtar youtube dhe në faqen zyrtare të komunës së Gjilanit në "Facebook", duke theksuar se pa transmetim medial nuk mund të vazhdohet punimet. "Meqë nuk është siguruar as sot transmetimi medial, është pamundësuar puna e Kuvendit", ka thënë shefi i grupit

të këshilltarëve të LDK-së, Avdyli Aliu.

Pas ndërprerjes së seancës, kryetari i komunës, Alban Hyseni, para një pjese të kuvendarëve (LV-PDK), ka thënë se transmetimi i seancave është duke u bërë vazhdimisht, duke e cilësuar si lojë të opozitës lëshimin e seancave. Ai theksoi se transmetimi në faqet e komunës po vlerësohet më pak nga opozita sesa transmetimi në portale. "Përveç kësaj (bartjes së mjeteve prej 2.5 milionë eurosh), ndryshimi i vetëm i bartjes së buxhetit që nga seanca e fundit, kur materiali është dorëzuar me kohë, është edhe te Shëndetësia



dhe Mirëqenia Sociale, ku nga 30 mijë i kemi 70 mijë euro. Unë e kuptoj që ata nuk do të rrinë për të votuar. E kuptoj që kjo është vetëm

lojë, mirëpo transmetimi i seancave është duke u bërë rregullisht. Komuna nuk e ka luksin të bëjë pagesë prej 600

eurosh për një seancë dhe konsideroj që nuk duhet të bëhet", ka thënë Hyseni.

Pas ndërprerjes së seancës kanë folur edhe asambleisti i LV-së, Ismajl Kurteshi dhe shefi i grupit të këshilltarëve të PDK-së, Bujar Nevzati, të cilët kanë kërkuar që për hir të interesit të qytetarëve të gjendet një zgjidhje e shpejtë që seancat e kuvendit të mbahen në mënyrë të vazhdueshme. Në fund, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Gjilanit, Kushtrim Kadriu, ka propozuar që javën e ardhshme të mbahet një takim në mes të kryetarit të komunës dhe shefave të grupeve të Kuvendit të Komunës për ta zgjidhur këtë problem.

## Gjashtë vjet pa Adem Demaçin, simbolin e sakrificës e të rezistencës

**PRISHTINË, 26 KORRIK** - Të premtën janë bërë gjashtë vjet pa simbolin e sakrificës e të rezistencës kombëtare, Adem Demaçin. Një grup i ish-të burgosurve politikë dhe bashkëveprimtarë kanë bërë homazhe te varri i Demaçit, duke e kujtuar atë në gjashtëvjetorin e vdekjes. Në këtë përvjetor asnjë institucion publik dhe komunal nuk shënuan ndonjë aktivitet për nder të jetës dhe veprimtarisë së tij.

Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se Demaçi ishte gazetar e shkrimtar, veprimtar e intelektual, i përndjekur dhe i burgosur politik, i lauruar për paqe, përfaqësues politik i luftëtarëve të lirisë, mendimtar dhe kritik. "Adem Demaçi ishte mishëruar me çështjen kombëtare shqiptare qysh në rinë, duke u kapur fort pas 'nanës Shqipëri', siç e kishte këshilluar nëna e tij. Studiues i letërsisë botërore dhe lexues i filozofisë së Hegelit, Adem Demaçi u bë mendja më e fuqishme dhe zëri më i guximshëm që i artikuloi interesat politike të shqiptarëve në Jugosllavi, gjatë gjysmës së dytë shekullit XX", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Edhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në "Facebook" ka



theksuar se rezistenca aktive dhe lufta për çlirim ishin ide të mishëruara tek Adem Demaçi, prijësi i popullit të Kosovës ndër dekada. "Baca Adem frymëzoi dhe

organizoi një popull të tërë në rrugën për çlirim. I pa nënshtruar, i pa devijuar nga synimet dhe ideat e tij, ai do të mbetet i paharrueshëm. Vepra e Bacës Adem do të mbetet

përherë një pasuri e pashtershme, e cila do të na shërbejë ndër breza si shembull se si luftohet për liri dhe si ngrihet populli në robëri. Adem Demaçi na mësoi se uniteti dhe

vendosmëria e një populli janë armët më të fuqishme kundër çdo armiku, çdo shtypje, dhe kundër çdo padrejtësie. I përjetshëm qoftë kujtimi për Adem Demaçin! Lavdi!", ka shkruar ajo.

Demaçin e ka përkujtuar edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili ka thënë se baca Adem do të jetë përjetësisht në zemrat dhe mendjet tona. "6 vjet pa Adem Demaçin - simbolin e sakrificës e të rezistencës dhe shembullin e atdhetarit të paepur, i cili ia kushtoi një jetë lirisë, demokracisë, Kosovës dhe popullit tonë. Përjetësisht në zemrat dhe mendjet tona, Baca Adem!", ka shkruar Krasniqi.

Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar Adem Demaçin, duke theksuar se ai ishte i pamposhtur. "Shqiptar që nuk njihje frikë e as zmbrapsje, frymëzim për breza të tërë në secilën rrethanë historike, edhe i brezit të trimave të UÇK-së që kurorëzuan përpjekjet shekullore të shqiptarëve për të jetuar të lirë në trojet e tyre", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Veprimtari i shquar shqiptar, Adem Demaçi, ka ndërruar jetë më 26 korrik të vitit 2018, në moshën 82-vjeçare.

## Shkolla në fshatin Sfeçël të Podujevës do të bëhet me sallë sportive

Podujevë, 26 korrik - Komuna e Podujevës dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) kanë

nënshkruar marrëveshje për mbështetje financiare të projektit "Ndërtimi i sallës së brendshme sportive në

Shkollën 'Ali Ajeti' në Sfeçël". Vlera e këtij projekti është 230 mijë euro, ndërkohë që, sipas kësaj

marrëveshjeje, MAPL-ja do të investojë 100 mijë euro, kurse komuna 130 mijë euro.





## Zana Spahiu jep dorëheqje nga udhëheqja e RTK-së

Prishtinë, 26 korrik - Ushtruesja e detyrës e drejtoreshës së përgjithshme të televizionit publik të Kosovës, Zana Spahiu, ka dhënë dorëheqje. Lajmi është konfirmuar për Radio Televizionin e Kosovës nga Spahiu. Dorëheqja do të jetë efektive nga 30 korriku, sipas transmetuesit publik. Dorëheqja e Spahiut vjen disa ditë pasi RTK-ja dhe RTK Live transmetuan një pjesë të një artikulli të portalit boshnjak "Slobodna Bosna" (Bosnja e Lirë), në të cilin supozohet se disa medie të caktuara në rajonin e Ballkanit i janë nënshtruar regjimit të Vuçiqit. Në atë artikull janë përmendur edhe dy portale të Kosovës, "Nacionale" dhe "Periskopi". Në Kosovë ka pasur reagime rreth këtij artikulli, kryesisht për faktin që RTK-ja transmetoi një pjesë të tekstit dhe ai më pas është shpërndarë prej disa deputetëve të pushtetit.

Partitë opozitare në Kosovë kanë thënë se ky medium është "shndërruar në vegël të interesit ordiner të pushtetit". Qeveria e Kosovës nuk është pronuar rreth këtij rasti, ndërsa ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë të mërkurën se i ka dhënë informacione Prokurorisë për dy portalet e përmendura të Kosovës,

me arsyetimin se "është e rëndësishme të dimë se kush financohet nga Serbia".

Më 24 korrik 16 organizata joqeveritare dhe tre aktivistë të shoqërisë civile në Kosovë kanë kërkuar dorëheqjen e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK).

Në reagimin e tyre, materiali i RTK-së është konsideruar "informacion dezinformues, me qëllim të sulmimit të mediave online, 'Nacionale' dhe 'Periskopi'".

Bordi i RTK-së ka mbajtur më 23 korrik një mbledhje të jashtëzakonshme dhe përmes një njoftimi ka thënë se është i shqetësuar për publikimin "e artikullit kontrovers në RTK", që e ka cilësuar si "lëshim të qartë", duke kërkuar sqarime të detajuara nga menaxhmenti.

### Çfarë portali është "Slobodna Bosna"?

Boro Kontiq, gazetar veteran nga Bosnjë-Hercegovina dhe drejtor i Qendrës Mediale në Sarajevë, ka shpjeguar për Radion Evropë e Lirë se "Slobodna Bosna" është një media e themeluar në vitet 1989-1990 nga Senad Avdiq. Sipas mendimit të tij, Avdiq ishte një nga gazetarët më të mirë në atë kohë dhe "Slobodna Bosna" një



nga mediet kryesore të besueshme që luajti një "rol revolucionar" në vitet 1990 në nxjerrjen në pah të planit për rrethimin e Sarajevës nga ushtria jugosllave. "Për shumë, ajo ishte një surprizë, por doli që shumica e asaj që publikuan ishte e vërtetë", ka thënë Kontiq.

Megjithatë, ai ka thënë se nuk e di nëse mund të flasë më për besueshmëri, pasi ky portal ka pësuar disa ndryshime. Në mesin e viteve '90 kjo media u kthye në gazetë të përjavshme dhe në 15 vitet e fundit është vetëm online. "Në një moment u fol shumë se ata u mbështetën nga SDA [Partia

e Veprimit Demokratik], partia më e madhe boshnjake. Nuk e di se çfarë po ndodh. Unë njoh disa nga gazetarët që punojnë atje, janë gazetarë të mirë, profesionistë. Prandaj, është një media që ka një të kaluar të madhe, por çfarë është sot, t'ju them të drejtën, nuk e di", ka thënë Kontiq.

## Digjen dy vetura të komunës së Zveçanit



**ZVEÇAN, 26 KORRIK** - Dy vetura, në pronësi të komunës së Zveçanit, janë dëmtuar nga zjarri, konfirmoi për Radion Evropë e Lirë, zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani. Sipas Elshanit, ngjarja ka ndodhur rreth orës 01:40 të mëngjesit të 26 korrikut. Veturat që u dogjën ishin para ndërtesës së komunës së Zveçanit. "Dyshohet se kemi të bëjmë me zjarrvënie, ndërsa të lënduar nuk ka", tha Elshani shkurt për REL-in.

Ai shtoi se policia është duke punuar për zbardhjen e rastit. Zveçani është një nga katër komunat në veri të Kosovës që

janë të banuara me shumicë serbe. Në këtë pjesë të territorit të Kosovës edhe në të kaluarën ka pasur djegie të veturave dhe dëmtim të pronës.

Në qershor të këtij viti u raportua për djegien e dy veturave me targa serbe në Mitrovicë të Veriut, ndërkaq në fillim të prillit një pjesëtarit të policisë kufitare të Kosovës iu dogj vetura në Mitrovicë të Veriut.

Në mars u regjistruan dy djegie të pronave të serbëve në Kosovë. Një lokal, në pronësi të nënkryetares së Zveçanit, Natasha Tomaniq, u dogj më 8 mars. Ajo dhe autoritetet e sigurisë thanë se zjarrvënia

dyshohet se ishte e qëllimshme. Ndërkaq më 24 mars u dogj një objekt në pronësi të Nenad Radosavleviqit, drejtor i Drejtorisë për Sport, Rini dhe Kulturë në komunën që funksionon sipas sistemit të Kosovës. Radosavleviq i tha Radios Evropë e Lirë se beson që zjarrvënia ishte e qëllimshme dhe se motivi ishte politik.

Raste me djegien e makinave u regjistruan veçanërisht shumë në fund të vitit 2022 dhe gjatë vitit 2023, kur u bë procesi i reregjistrimit të veturave me targa të Kosovës. Për këtë arsye persona të panjohur dogjën disa vetura me targa RKS (Republika e Kosovës).

## Arrestohen dy shtetas të Kolumbisë në Prishtinë, dyshohen për mashtrim

**PRISHTINË, 26 KORRIK** - Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë, respektivisht hetuesit e stacionit policor Jugu, kanë arrestuar dy persona të dyshuar për disa raste të mashtrimit, si dhe kanë sekuestruar një sasi të parave, (dyshohet të përfituara duke kryer vepra mashtrimi). "Personat e dyshuar: mashkull 47 vjeç, shtetas i Kolumbisë dhe femër 28 vjeç, shtetase e Kolumbisë. Me vendim të prokurorit, janë dërguar në

Qendrën e Mbajtjes për 48 orë. Personat e arrestuar dyshohet të kenë marrë nga ankuesit (punëtor të këmbimoreve) shuma të ndryshme parash duke i mashtruar (gjatë rinumërimit kanë fshehur një shumë parash derisa kanë qenë duke i konvertuar", ka njoftuar policia.

Mbështetur në rezultatet e para të hetimit, policia ka ngritur dyshimin e bazuar se mashtrimet mund të kenë

ndodhur në vazhdimësi edhe jashtë rajonit të Prishtinës, si dhe dyshohet se numri i personave të mashtruar nga personat e dyshuar mund të jetë më i madh sesa numri i raportuar. "Kërkojmë nga qytetarët që mund të kenë qenë viktimë e rasteve të tilla të lajmërohen në stacionin më të afërt policor, për të ndihmuar policinë drejt hetimit përfundimtar", ka njoftuar Policia e Kosovës.





## Dogana e Kosovës konfiskon afër gjysmë milion euro ari dhe argjend

PRISHTINË, 26 KORRIK - Rreth gjysmë milion euro ari dhe argjend pa dokumentacion janë konfiskuar nga Dogana e Kosovës në qytetin e Prizrenit, pas një operacioni të përbashkët me zyrtarë të Administratës Tatimore të Kosovës në disa argjendari. “Zyrtarët e Doganës së Kosovës

dhe të Administratës Tatimore të Kosovës kanë kryer një operacion të përbashkët kontrolli në pesë argjendari në qytetin e Prizrenit. Ky operacion u fokusua në identifikimin e mallrave pa prejardhje të dokumentuar në kuadër të përpjekjeve për të luftuar kontrabandën dhe

tregtinë e paligjshme. Rezultatet e operacionit si në vijim: 10 kg ari pa dokumentacion të rregullt. 3 kg argjend pa dokumentacion të rregullt. Vlera totale e këtyre mallrave të konfiskuara arrin rreth 450,000.00 euro. Kontrollet u kryen në disa lokacione të ndryshme brenda

qytetit të Prizrenit. Zbulimi i këtyre mallrave u bë falë punës së palodhur dhe përkushtimit të zyrtarëve të Doganës dhe Administratës Tatimore. Dyshohet se këto mallra janë kontrabanduar”, ka njoftuar Dogana, duke u bërë thirrje qytetarëve të jenë vigjilentë dhe të raportojnë çdo aktivitet



të dyshimtë që mund të ndihmojë në luftën kundër kontrabandës dhe aktiviteteve të paligjshme.

## FMN-ja konfirmon mbështetjen ndaj BQK-së

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 KORRIK - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, së bashku me zëvendësguvernatorët Milot Cakaj dhe Dardan Fusha, kanë pritur në takim shefin e ri të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për Kosovën, David Amaglobeli, shoqëruar nga Sebastian Sosa dhe Selim Thaçi.

Guvernatori Ismaili e uroi Amaglobelin për pozitën e re dhe shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin ndërmjet BQK-së dhe FMN-së.

Gjatë këtij takimi ai e informoi Amaglobelin për zhvillimet në sektorin financiar dhe ecuritë ekonomike, zbatimin e Planit Strategjik, funksionalizimin e strukturës së re organizative dhe reformat e tjera në BQK me qëllim të ngritjes së kapaciteteve. Gjithashtu, guvernatori Ismaili e informoi Amaglobelin për përmbushjen e rekomandimeve që dalin nga dy programet e FMN-së:



Stand-By Arrangement (SBA) dhe Resilience and Sustainability Facility (RSF), si dhe rekomandimet e asistencave teknike.

Gjatë takimit shefi i Misionit të FMN-së u informua për angazhimin e BQK-së për reformat legjislativë, digjitalizimin, angazhimet për anëtarësim në SEPA, avancimin e mbrojtjes së konsumatorit dhe agjendën e gjelbër.

Amaglobeli falënderoi guvernatorin Ismaili për

bashkëpunimin ndërmjet FMN-së dhe BQK-së dhe e informoi për planet dhe prishmëritë e FMN-së në kuadër të politikave ekonomike dhe financiare si dhe marrëveshjeve me FMN-në.

Në vijim, Amaglobeli e siguroi guvernatorin Ismaili për mbështetjen e FMN-së ndaj BQK-së për reformat e ndërmarra dhe nismat e tjera në funksion të avancimit të sistemit financiar në vend.

Të dyja palët u zotuan se

bashkëpunimi do të vazhdojë dhe do të avancohet më tej për arritjen e rezultateve të tjera në funksion të qëndrueshmërisë së sistemit financiar dhe rritjes së qëndrueshmërisë ekonomike.

Amaglobeli ka punuar në disa vende dhe misione të ndryshme të FMN-së si dhe në pozitën e guvernatorit dhe zëvendësguvernatorit në Bankën Qendrore të Gjeorgjisë, ku ka drejtuar reformat e rëndësishme institucionale.

Edhe zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur në takim shefin e ri të FMN-së në Kosovë, David Amaglobeli.

Zëvendëskryeministri Bislimi i uroi mirëseardhje Amaglobeli në vendin tonë, në vizitën e tij të parë në Kosovë. Përgjatë takimit zëvendëskryeministri Bislimi e njoftoi atë për aktualitetin në vend në rrafshin ekonomik dhe indikatorët makroekonomikë. Më tej u diskutua mbi vizitën e ardhshme në Kosovë të stafit të FMN-së, përgjatë së cilës në mënyrë të zgjeruar do të njihen edhe më tej me situatën ekonomike në vend përmes takimeve të ndryshme bilaterale me institucionet vendore.

Duke shprehur mirënjohjen për ndërveprimin e vazhdueshëm dhe të frytshëm me FMN-në, zëvendëskryeministri theksoi vlerësimin për pikëpamjet e ndara në këtë takim dhe vullnetin e gatishmërinë për thellim të bashkëpunimit.

## Raporti i UNDP-së, 36.8 për qind e të anketuarve të pakënaqur me drejtimin ekonomik aktual

PRISHTINË, 26 KORRIK - Është publikuar edicioni i 26 i Përmbledhjes së Pulsit Publik, ndërkaq të dhënat për këtë janë mbledhur nga 17 prilli deri më 7 maj 2024, duke reflektuar opinionin e mbi 1 300 të anketuarve. Përveç të tjerash, anketimi i opinionit të Pulsit Publik nxjerr në pah perceptimet e njerëzve për çështjet socio-ekonomike.

Një rritje pozitive e perceptimit për drejtimin ekonomik është shënuar në anketën e majit të vitit 2024, ku 27.3 % janë deklaruar shumë të kënaqur ose të kënaqur me

drejtimin ekonomik të Kosovës, krahasuar me 20.20 % në maj të vitit 2023.

Gjithsej 35.9 % e të anketuarve kanë qenë neutralë krahasuar me 32.1 % në nëntor të vitit 2023 dhe 36.8 % kanë qenë shumë të pakënaqur ose të pakënaqur krahasuar me 47.70 % në nëntor të vitit 2023.

Një numër më i madh i burrave (31.2 %) krahasuar me gratë (23.4 %) kanë qenë shumë të kënaqur apo të kënaqur me drejtimin ekonomik drejt të cilit po shkon Kosova. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike kanë



treguar se 44.2 % e komuniteteve të tjera të Kosovës janë shumë të kënaqura ose të kënaqura me drejtimin ekonomik, krahasuar me 26.8 % të shqiptarëve të Kosovës dhe 11 % të serbëve të Kosovës.

Të dhënat e majit të vitit 2024 tregojnë rritje të kënaqshmërisë me drejtimin ekonomik tek të gjitha etnitë, krahasuar me nëntorin e vitit 2023, kur 28.8 % e komuniteteve të tjera të Kosovës kanë qenë të kënaqura me drejtimin ekonomik, të pasuar nga 19.5 % të shqiptarëve të Kosovës dhe 7.6 % të serbëve të Kosovës.

## Ulje e perceptimit publik për korrupsion në ATK

PRISHTINË, 26 KORRIK - Raporti i fundit nga UNDP, Puls Publik XXVI, tregon se niveli i perceptimit të korrupsionit në Administratën Tatimore të Kosovës ka rënie të theksuar në 17.1 %, krahasuar me 26.40 % sa ishte vitin e kaluar.

Numrat tregojnë përpjekjet e vazhdueshme për ta

përmirësuar transparencën dhe efikasitetin e institucionit.

Rënia e perceptimit të korrupsionit vjen si rezultat i masave të rrepta që janë ndërmarrë për ta përmirësuar qeverisjen e brendshme, për ta rritur përgjegjësinë dhe për t'i zbatuar reformat e reja antikorrupsion.

“Këto masa përfshijnë rritjen e transparencës: prezantimi i procedurave më të qarta dhe më të hapura për trajtimin e çështjeve tatimore; kontrollin dhe mbikëqyrjen: forcimin e mekanizmave të brendshëm të kontrollit dhe inspektimeve të pavarura; trajnimin dhe edukimin: organizimi i

trajnimeve të rregullta për stafin mbi praktikatat më të mira për parandalimin e korrupsionit; angazhimin e publikut: fushata sensibilizimi për të inkurajuar qytetarët që të raportojnë raste të dyshimta të korrupsionit. Ne jemi të përkushtuar të vazhdojmë me reformat dhe përmirësimet, për të siguruar që



ky trend pozitiv të vazhdojë dhe të rrisim më tej besimin e publikut në sistemin tonë tatimor”, ka njoftuar ATK-ja.



# Parisi – nga Balzacu te periferitë

Nga: Lauren ELKIN

/ The Financial Times

Në mesin e viteve 1840, në gjendjen melankolike shpirtërore përkritazi me serinë e modernizimeve që po përjetonte në Paris, në romanin e tij të papërfunduar, Borgjezi i vogël [Les Petits Bourgeois], Honoré de Balzac ka shkruar: “Mjerisht! Parisi i vjetër po zhduket me ritëm të frikshëm”. Gjashtëmbëdhjetë vjet më vonë, gjatë rinovimit në shkallë të gjerë të Parisit nga [Georges-Eugène] Haussmanni, midis viteve 1853-1870, Charles Baudelaire këtë lloj transformimi do ta konsideronte si thelbin e asaj që do të thotë të jetosh në një qytet, duke shkruar në Lulet e së keqes [Les Fleurs du Mal]: “Mjerisht, forma e qytetit ndryshon më shpejt sesa zemra e njeriut”. Mjerisht, mjerisht!

Tani është radha jonë të pyesim se cilin lloj të Parisit po e lëmë si trashëgimi për të ardhmen. Si pjesë e projektit të Parisit të Madh [Grand Paris], qyteti aktualisht po përjeton ndryshimin rënësor nga një qytet i vogël me 2.2 milionë banorë të cilët jetojnë në 105 kilometra katrorë, në një metropol që përfshin 6.7 milionë njerëz me mbi 762 kilometra katrorë. Linjat e reja të metrosë janë ndërtuar dhe ato do të hapen së shpejti, duke ua mundësuar parisianëve që të lëvizin më shpejt se kurrë midis qytetit dhe periferisë së tij; gentrifikimi [1] është tashmë në proces në periferitë e tilla si Ponta [Pantin], Montrej [Montreuil] ose Obervilie [Aubervilliers], ndërsa çmimet e banesave pritet të rriten.

Tani më me fillimin e Olimpiadës, vëmendja e botës po kthehet kah Parisi – ose më mirë te periferitë e tij ku do të mbahen shumica e ngjarjeve. Dhe, nga lajmet kryesore që vijnë përpara Lojërave, është edhe ndikimi real që kjo ka te mijëra njerëz të pastrehë, punonjës seksi dhe migrantë të cilët largohen me autobusë nga kryeqyteti dhe kërcënohen me dëbim në përgatitjet e bëra për vizitorët dhe për kameramanët.

Ashtu si Balzacu dhe Baudelairei në kohën e tyre, shkrimtarët dhe gazetarët ia kanë kushtuar vëmendjen e madhe këtyre ndryshimeve, duke pyetur jo vetëm se si qyteti po ndryshon, por pse dhe kush përfiton. Dy librat e rinj të analizuar këtu – Zona: Historia alternative e Parisit [The Zone: An Alternative History of Paris] i Justinien Tribillonit dhe Parisi: Qyteti si komedi njerëzore [Paris: The City as Human Comedy] i Eric Hazanit – janë disa ndër titujt e kohëve të fundit që merren me Parisin që kemi trashëguar dhe të ardhmen që mund të paramendohet për të.

E përbashkëta e tyre është

përkushtimi për të parandaluar imazhin e Parisit si hapësirë me kalldrëm që nuk merret me të rëndomtët, ku të gjithë janë elegantë dhe të veshur me stil dhe të cilët lexojnë filozofi teksta pinë duhan në një kafene. Parisi mund të ishte “vend përrallor”, shkruante Balzacu, por ishte gjithashtu vend me baltë, i ndyrë; karakteri Rastinjak në romanin e tij të vitit 1835, Xha Gorio [Le Père Goriot], i cili kur udhëtonte nga një pjesë e qytetit në tjetrin duhej të merrte “një mijë masa paraprake për të mos u zhytur me baltë... duhej të lustronte çizmet dhe t’i pastronte pantallonat në Pallatin Mbretëror [Palais-Royal]”.

Zgjerimi i njohurive tona për Parisin ishte misioni i Eric Hazanit, qëkur ai iu kthye shkruar në moshën 66-vjeçare – pas karrierës si kardiokirurg peditatër (dhe si themelues i Shtëpisë Botuese La Fabrique). Hazani, i cili vdiq në qershor në moshën 87-vjeçare, u specializua në ndikimin e politikave represive të shtetit francez në formësimin e Parisit, duke i studiuar ato në një seri të librave, përfshirë këtu Shpikjen e Parisit [Invention of Paris, 2010], Historinë e barrikadës [A History of the Barricade, 2015] dhe Ecjen nëpër Paris [A Walk Through Paris, 2018] – në një udhëtim në këmbë përmes “rripit të kuq” të qyteteve komuniste [të dominuara nga komunistët në vitet 1920-’80] në jug të qytetit.

Shekujt me trazira politike, rinovimet në shkallë të gjerë dhe me pakënaqësi e racizëm të kultivuar, bënë që klasat e rrezikshme të zhvendoseshin në periferi, ndërsa qendra e qytetit të pretendohet nga të pasurit. Për ta kuptuar Parisin, argumenton urbanisti Justinien Tribillon, “duhet të dëgjosh zërat e Zonës”, me çfarë ai nënkupton hapësirën midis qytetit dhe periferisë. Në rrefimin e tij të interesant për jetën mes hapësirave të ndërmjetme të kryeqytetit për klasën punëtore dhe për emigrantët afrikano-veriorë nga mesi i shekullit XIX e deri në ditët e sotme, Tribillon rezulton të jetë pasardhës i denjë i Hazanit, megjithëse fryma e tij udhëheqëse është më shumë si ajo Victor Hugos sesa Honoré de Balzacut.

Zona ishte nënprodukt i Murit të Tierit [Enceinte de Thiers], një fortifikim ushtarak i ndërtuar në vitin 1841, i cili përfundimisht u zëvendësua nga unaza e sotme e njohur si periferia [periferique] e inauguruar më 1973. Libri i Tribillonit është historia e parë e thellë e kësaj hapësire ku u shfaq një shtresë e banesave të improvizuara. Të veçuar nga mungesa e pastërtisë apo moralit, zonalinjtë dhe shtëpitë e tyre “u bënë antonim i qytetërimit: në skajet e qytetit të dritave qëndronte humnera e tij, pylli i tij i errët, haleja e tij, toka e tij e askujt”.



Qendra e bukur e qytetit të Haussmannit, me bulevardet e gjata elegante, ballkonet e zbukuruar dhe stolat prej hekuri të farkëtuar, nuk ishin për ta.

Aktivistët dhe nëpunësit civilë me qëllime të mira, u përpoqën të trajtonin problemin e Zonës gjatë gjithë shekullit XIX dhe shekullit XX. Në vitet 1940, një “rrip i gjelbër” u vendos si formë e “higjienës sociale”, duke lejuar klasat punëtore, të cilat jetonin në skaj të qytetit, që të përfitonin nga ajri dhe nga hapësira e pastër. Por, mbjellja e pemëve nuk është në vetvete akt dashamirësie; Tribilloni bindshëm tregon se rripi mund të jetë gjithashtu “tampon”, duke analizuar përmes Francës së Vishit rrënjët e politikës së gjelbër urbane të shekullit XX dhe XXI dhe ekuivalencën që ajo tërhoqi jo vetëm midis moralit dhe parandalimit të sëmundjeve, por edhe “prejardhjes, racës, gjakut dhe fesë”. Duhet vetëm të mbani mend ministrin e atëhershëm të Brendshëm, Nicolas Sarkozy, i cili më 2005 premtonte se do të pastronte periferitë me ujë me presion, për të parë se disa nga këto ide janë ende pjesë e jona.

Në vitin 1954, vetë unaza fillimisht u konceptua si pjesë e brezit të gjelbër, e destinuar për t’u veshur me pemë dhe trotuare. Por, roli i natyrës shpejt zuri vendin e dytë dhe periferia u shndërrua në “pronën më pak të dëshirueshme në të gjithë Parisin”.

Nga fundi i librit të Tribillonit, autori bën një shëtitje në një projekt strehimi – në një rrugë të quajtur “Onore de Balzac” [Rue Honoré de Balzac] – në periferinë veriore La Kurnëv [La Courneuve], në një nga lokacionet e Olimpiadës së ardhshme. Për Tribillonin, këto projekte – les grands ansambles, siç quhen – janë mundësi e dështuar për shtetin për të ndërtuar banesa sociale të cilat vërtet janë funksionale, ku ka shërbim transporti dhe rehati, duke ftuar një përzierje të klasave shoqërore; në vend të kësaj, qëllimet e mira të planifikuesve fillestarë u shkatërruan nga buxhetet e

pakësuar dhe nga angazhimi për të ndërtuar jo më mirë, por më shpejt. Ajo që Tribilloni e quan “miti i së kuqes periferike”, nuk është rezultat i forcave të paepura shoqërore, por i ideologjisë dhe mungesës së vullnetit politik.

Aty ku Tribilloni skicon historinë e periferisë së jashtme të Parisit, Hazani na çon në një turne në qendrën historike. “Itinerari” parisian i Hazanit i Komedisë njerëzore, ciklit epik të romaneve, tregimeve dhe eseve të Balzacut për shoqërinë franceze të kohës së tij, na shpie nëpër Parisin e Monarkisë së Korrikut (e cila zgjati në 1830-1848, nën mbretin e fundit francez, Louis-Philippe). Balzacu e njihte qytetin nga afër, pasi kishte jetuar në jo më pak se 11 rezidenca midis viteve 1829 dhe 1847, periudhë gjatë së cilës shkroi 91 pjesët e përfshira në Komedinë njerëzore.

Parisi i Balzacut lehtësisht mund të ndahet në dysh: Parisi i vjetër dhe ai i ri. Parisi i vjetër, shkruan Hazani, “përfshihet brenda harkut të Bulevardit të Madh [Grands Boulevards] ... Kryesisht ende mesjetar në arkitekturën e vet dhe në rrëmujën e rrugëve të veta, ai pothuajse nuk ka ndryshuar që nga fundi i regjimit të vjetër”. Por, në kohën e tij, Balzacu pa një Paris tjetër të formësohej “midis bulevardëve dhe Murit të Tatimpaguesve [Mur des Fermiers généraux] që kufizonte qytetin ... Shfaqja e rretheve të tëra, spekulimet financiare, ndërtimet e pasanikëve të rinj [nouveaux riches] – kjo është zhurma e sfondit të Komedisë njerëzore, një pamje e pakrahasueshme e formimit të një qyteti”.

Megjithëse ai nuk jetoi për të parë riparimin masiv të Haussmannit – vdiq tri vjet para se prefekti i Senës [Haussmann] të vinte në pushtet – Balzacu shkroi për zhvillimin e rretheve si Shose d’Onta [Chaussée-d’Antin], Nuvel-Aten [Nouvelle Athènes], zonat përreth Kishës Notre-Dam-de-Loret, San-Zhorzh [Saint-Georges] dhe Evropa [Europe], të cilat do të bëhen, siç shkruan Hazani, “zona më e gjallë, më argëtuese, më e

pasura ... më artistike e Parisit – dhe epiqendra e Komedisë njerëzore”. Hazani na tregon se Balzacu ka bërë një shëtitje në Murin e Tierit, në fillim të viteve 1840, duke vënë në dukje fortifikimet dhe rrugët e bukura në të dyja anët, “të bukura si pasqyra”, por nëse e ka parë Zonën, ai për këtë nuk tha asgjë.


Ajo që nxiti interesimin e Balzacut ishin shokët e tij parisienë, mosmarrëveshjet, grindjet dhe luftërat e tyre, lakmia dhe koprracia e tyre, pasioni dhe fatkeqësia e tyre. Askush kurrë nuk mërzhitet në Parisin e Balzacut; të gjithë personazhet e tij janë, siç tha Baudelaire, “deri në dhëmbë të mbushur me fuqinë e vullnetit”. Në një rresht që nuk do të ishte i pavend në librin e Tribillonit, Balzacu e pa qytetin e Parisit si “fushë të gjerë të nxitur vazhdimisht nga stuhia e interesave” – asnjëherë si sfond i thjeshtë, sipas mendimit të Hazanit, por si pjesë e natyrshme e njerëzve të cilët jetojnë atje, po aq sa “fiziku, veshja apo psikologjia e tyre”.

Për lexuesit që nuk janë të njohur me të gjitha (ose ndonjë) veprat e Balzacut, libri mund të jetë i vështirë për t’u ndjekur; këta banorë të qytetit të tij bëjnë vals brenda dhe jashtë rrefimit, duke u bashkuar dhe duke u shpëputur, duke u munduar dhe duke u fshehur, duke luajtur bixhoz dhe duke vdekur. Por, është udhëtim që ia vlen ta bëjmë, duke na kujtuar se përmes rinovimeve të tij të shumta, Parisi ka mbetur vend ku “secili pi duhan, gjithçka digjet, gjithçka shkëlqen, gjithçka fluskon, gjithçka flakëron, avullon, shuhet, ringjallet, xixëllon, vërshelet dhe shpenzohet”. /Telegrafi/

[1] Procesi ku karakteri i një zone të varfër urbane ndryshohet prej njerëzve më të pasur që lëvizin aty, duke përmirësuar vendbanimet dhe duke tërhequr bizneset e reja, por duke zhvendosur dalëngadalë banorët aktual



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Osmani: Fryma olimpike i kapërcen kufijtë

PRISHTINË, 26 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani është prititur në takim nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron dhe zonja e parë, Brigitte Macron, në nder të hapjes zyrtare të Lojërave Olimpikë "Paris 2024". Këtë presidentja Vjosa Osmani e ka bërë të ditur përmes një postimi në profilin e saj në rrjetin social "Facebook". Ajo ka shkruar se fryma olimpike i kapërcen

kufijtë. "Në Pallatin Elysee, bashkë me Prindonin u mirëpritëm nga Presidenti Emmanuel Macron dhe Zonja e Parë, Brigitte Macron, në nder të hapjes zyrtare të Lojërave Olimpikë 'Paris 2024'. Fryma olimpike i kapërcen kufijtë, përbashkon njerëzit dhe kombet dhe tregon fuqinë e sportit", ka shkruar presidentja Osmani në "Facebook".

## Kurti nga Parisi, sportistëve të Kosovës: U priftë e mbara

PRISHTINË, 26 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, përmes një njoftimi në rrjetet sociale ka bërë të ditur se ka udhëtuar në Paris, atje ku po mbahen Lojërat Olimpikë 2024. Ai gjithashtu mori pjesë edhe në darkën e shtruar nga Presidenti i Komitetit Ndërkombëtar, ku ishte i ftuar së bashku me gruan e tij. "Në Paris, për të marrë pjesë në darkën e shtruar nga Presidenti i Komitetit Ndërkombëtar, dhe për të

mbështetur sportistët tanë që na përfaqësojnë krenarisht në Lojërat Olimpikë 2024. U priftë e mbara", ka shkruar Kurti. Kujtojmë se ekipi olimpik i Kosovës përbëhet nga nëntë sportistë, ndërsa gara filluan të premten dhe do të zgjasë deri më datë 11 gusht. Gjashtë është numri i sportistëve të kualifikuar, pesë nga xhudo dhe një nga boksi, si dhe tre sportistë me ftesë të univerzalitetit, dy nga noti dhe një nga atletika.



## Distria Krasniqi e nis e para aventurën e xhudistëve nga Kosova në Lojërat Olimpikë 'Paris 2024'

PRISHTINË, 26 KORRIK - Xhudistët nga Kosova pritet të sjellin sërish medalje nga Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Sonte është hapja zyrtare e Lojërave Olimpikë dhe nga Kosova marrin pjesë nëntë sportistë, por sigurisht që vëmendja më e madhe është tek

xhudo - nga sporti ku kemi më shumë medalje në këto evente. Ndeshja e parë e ekipit olimpik të xhudos është të dielën, në orën 10:00, ku do të ndeshet kampionia olimpikë, Distria Krasniqi. Nora dhe Akil Gjakova do të ndeshen të hënën më 29

korrik, po ashtu nga ora 10:00. Laura Fazliu ndeshet të martën, 30 korrik 2024, 10:00 dhe Lorian Kuka ndeshet të mërkurën, 01 gusht 2024, 10:00. Kujtojmë që këto Lojëra Olimpikë do të mbahen nga data 26 korrik deri më 11 gusht në Paris të Francës.

## Malisheva ndan rrugët me trajnerin Qëndrim Kida

MALISHEVË, 26 KORRIK - Skuadra e Malishevës ka njoftuar se ka ndarë rrugët me trajnerin, Qëndrim Kida. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", klubi malishevas ka bërë të ditur se me përfundimin e kontratës, Kida nuk do të udhëheqë më skuadrën. "Pas një periudhe të shkëlqyeshme bashkëpunimi,

klubi dhe kryetrajneri Qëndrim Kida, me rastin e përfundimit të kontratës së trajnerit, ndajmë rrugët. Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për përkushtimin, profesionalizmin dhe mbështetjen që na keni ofruar gjatë kësaj kohe", thuhet ndër të tjerash në njoftimin e klubit. Qëndrim Kida ishte në

krye të skuadrës, kur Malisheva përfundoi në vendin e katërt në tabelën e sezonit e kaluar. Po ashtu, Kida i udhëhoqi ata edhe në garat evropiane për herë të parë në histori të klubit, mirëpo duke u eliminuar nga Buducnosit qysh në fazën e parë kualifikuese për Ligën e Konferencës.





**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pikë 4, "AQ Tolaj" Sh.p.k Deçan në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunitetin organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaik 2MW në Prilep, Deçan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.09.2024 në ora 11:00 në objektin e komunës së Deçanit, do të organizohet debat publik nga Kompania "AQ Tolaj" Sh.p.k Deçan në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Komunitetin.

Debatin Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

[https://eu-central-1-protection.sophos.com/?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA0d2VlLnRvbn20udXMvaai80NT05MzQ0NDk1P3B3ZD1HY1cjb2NjU1d4Mz1GM2U4UUUY3UHNBa0NNM2J2SzYulMQ=&i=NjQ1Y2l1MTQyMniwZTM3YjNiOGQ4Y2Ix&t=YkZxNVAxTIRhRzFCQUFJSmlwS1pwUTZoOUZFUmoxQzFSeVM2T3RacG1FUT0=&h=e3734878f20b49f0bc85b8c9956136b4&s=AVNPUehUT0NFTiKNSWVBUSVaTRAueU-vNbNdW92a0FAisFOgf0Rln55\\_29at16bUHiQ](https://eu-central-1-protection.sophos.com/?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA0d2VlLnRvbn20udXMvaai80NT05MzQ0NDk1P3B3ZD1HY1cjb2NjU1d4Mz1GM2U4UUUY3UHNBa0NNM2J2SzYulMQ=&i=NjQ1Y2l1MTQyMniwZTM3YjNiOGQ4Y2Ix&t=YkZxNVAxTIRhRzFCQUFJSmlwS1pwUTZoOUZFUmoxQzFSeVM2T3RacG1FUT0=&h=e3734878f20b49f0bc85b8c9956136b4&s=AVNPUehUT0NFTiKNSWVBUSVaTRAueU-vNbNdW92a0FAisFOgf0Rln55_29at16bUHiQ)

Meeting ID: 454 934 4495  
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "AQ Tolaj" Sh.p.k Deçan për impiantin fotovoltaik 2MW në Prilep, Deçan.

<https://numphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emailin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Kleopatra Tahiri nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën për parukeri të lëshuar nga QAP—Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Vilson Kurti shpall të pavlefshme dëftesat dhe certifikatën e testit të maturës dhe diplomën e shkollë së mesme "Arkitekt Sinani".
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Nevzat Berisha shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme profesionale "Bahri Haxha"-ish shkolla e mesme "Muharrem Bekteshi".
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1908

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1908  
0.5L





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

